

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së Këshillit, **Saida Dollani**, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar (në vijim ligji nr. 8577/2000), Kuvendi i Republikës, në datën 28.08.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të mbarimit përpara afatit ligjor të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo.

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në përfundim të procedurës së verifikimit të kandidaturave, me Vendimin nr. 115, datë 09.08.2019, vendosi:

- Njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018.

3. Në zbatim të vendimit nr. 115, datë 09.08.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000, Kuvendi i Republikës, në datën 21.08.2019, ka rishpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të mbarimit përpara afatit ligjor të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo.

4. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe z. Shaqir Hasanaj.

5. Në vijim, nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me Vendimin nr. 136, datë 21.09.2019, u vendos:

- Fillimi i procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të rishpallur nga Kuvendi në datën 21.08.2019.

6. Në zbatim të nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*” (në vijim ligji nr. 115/2016), dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2, datë 15.02.2019 “*Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion*”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 21.09.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për vendin vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese.

7. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, z. Fatri Islamaj. Gjatë zhvillimit të procedurave të verifikimit për këtë pozicion vakant, rezultoi se relatori, Fatri Islamaj, me vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në datë 10.12.2019 është shkarkuar nga detyra. Në kushtet kur ligji parashikon pezullimin e menjëhershëm nga detyra e gjyqtarit, për shkak të këtij vendimi Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 11.12.2019, ka realizuar përsëri shortin manual. Sipas shortit, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, znj. Vitore Tusha. Për shkak të përfundimit të mandatit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (i përkohshëm) 2019, zhvillimi i procedurave të verifikimit për këtë pozicion vakant i kaluan Këshillit të Emërimeve në Drejtësi 2020, i cili në datën 15.01.2020 zhvilloi shortin manual dhe relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave është caktuar anëtarja e Këshillit, znj. Saida Dollani. Sipas parashikimit të pikës 5/2, shkronja “b”, të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019, të ndryshuar, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, relatorja Saida Dollani kontrollloi saktësinë dhe plotësinë e veprimeve të kryera dhe konfirmoi veprimet e relatorëve të mëparshëm.

8. Z. Shaqir Hasanaj, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, është njoftuar me shkrim për t’u paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati Shaqir Hasanaj, gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

9. Në datën 24.09.2019, kandidati Shaqir Hasanaj është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

10. Në datën 26.09.2019, kandidati Shaqir Hasanaj ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklaramit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

11. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 548 prot., datë 04.10.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas ligjit nr. 8577/2000 dhe ligjit nr. 115/2016.

12. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati Shaqir Hasanaj, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatis për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

13. ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim ligji nr. 9049/2003) dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim ligji nr. 9367/2005), me shkresën nr. 113/25 prot., datë 07.11.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Shaqir Hasanaj dhe personat e lidhur me të.

14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatis Shaqir Hasanaj dhe personave të lidhur me të.

15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatis Shaqir Hasanaj, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 09.10.2019, i është drejtuar me kërkesa për informacion dhe ka marrë përgjigjet përkatëse me të dhënat e kërkuara nga secili prej institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit), si vijon:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Kreditit e Shqipërisë, (6) Banka e Parë e Investimeve, (7) Banka Intesa Sanpaolo, (8) Banka Kombëtare Tregtare, (9) Banka Ndërkombëtare Tregtare, (10) Banka Procredit, (11) Banka Raiffeisen, (12) Banka Societe Generale, (13) Banka Tirana dhe (14) Banka Union.
- b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF, (15) Tirana Factoring & Lease, (16) Tranzit sha, (17) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekte financiare të licencuar nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit WVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- ç) Institucione të tjera publike si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

16. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse, me përjashtim të Bankës Alpha Albania, e cila, deri në momentin e përpilimit të këtij akti, nuk ka kthyer përgjigje.

17. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 603 prot., datë 09.10.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati Shaqir Hasanaj sipas ligjit nr. 138/2015 “*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*” (në vijim ligji nr. 138/2015).

18. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 2690/114 prot., datë 21.11.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Shaqir Hasanaj.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatis Shaqir Hasanaj, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i është drejtuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (shkresa nr.602 prot., datë 09.10.2019) dhe me kërkesë për informacion Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (shkresa nr.604 prot., datë 09.10.2019).

20. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me shkresat nr.3777 prot., datë 21.11.2019, si dhe nr.2155 prot., datë 22.10.2019, e nr.2050/2 prot., datë 28.10.2019.

21. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015 “*Për të drejtën e informimit për dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*” (në vijim ligji nr. 45/2015), si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 601 prot., datë 09.10.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati Shaqir Hasanaj për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

22. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 1386/4 prot., datë 25.10.2019, ka dërguar Vendimin nr. 671, datë 25.10.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Shaqir Hasanaj.

23. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91 e 93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidati Shaqir Hasanaj në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

24. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, Këshilli në datën 16.10.2019 i është drejtuar me kërkesë për informacion partive politike, duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Në përgjigje të këtyre kërkesave, partitë politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidatin Shaqir Hasanaj.

25. Gjithashtu për këtë rast kandidimi, Këshilli vlerësoi t’i drejtohet me kërkesa për informacion disa institucioneve publike dhe subjekte private, pranë të cilave kandidati Shaqir Hasanaj ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të kandidatit si Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Drejtësisë (*shkresa nr. 690 prot., datë 18.10.2019*), Radio Televizionit Shqiptar (*shkresa nr. 688 prot., datë 18.10.2019*), Presidentit të Republikës (*shkresa nr. 687 prot., datë 18.10.2019*), Këshillit të Lartë Gjyqësor (*shkresa nr. 686 prot., datë 18.10.2019 dhe shkresa nr. 715 prot., datë 08.11.2019*), Dhomës Kombëtare të Avokatisë (*shkresa nr. 685 prot., datë 18.10.2019*), Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (*shkresa nr. 691 prot., datë 18.10.2019*), Institutit të Sigurimeve Shoqërore (*shkresa nr. 689 prot., datë 18.10.2019*).

26. Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (*s’ka përgjigje*), Radio Televizioni Shqiptar (*shkresa nr. 2994/1 prot.*), Presidenti i Republikës (*shkresa nr. 3795/1 prot., datë 05.11.2019*), Këshilli i Lartë Gjyqësor (*shkresa nr. 5180 prot., datë 25.10.2019 dhe shkresa nr. 5591/1 prot., datë 13.11.2019*), Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë (*shkresa nr. 462 prot., datë 24.10.2019*), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (*shkresa nr. 51839/1 prot., datë 31.10.2019*), Instituti i Sigurimeve Shoqërore (*shkresa nr. 7230 prot., datë 23.10.2019*).

27. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 12.02.2020, nëpërmjet një e-maili, i ka kërkuar shpjegime kandidatit, z. Shaqir Hasanaj, lidhur me faktin e masave disiplinore të evidentuara në shkresat e sjella nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe lidhur me natyrën juridike të pozicionit të ushtruar pranë Presidentit të Republikës. Kandidati, me shkresën nr. 51 prot., datë 17.02.2020, ka depozituar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi sqarimet përkatëse dhe një kopje të Vendimit datë 13.10.1999 të Gjykatës Kushtetuese, një kopje të Vendimit nr. 3, datë 20.02.2006 të Gjykatës Kushtetuese.

28. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikës 95 dhe 96 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, duke vlerësuar se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, anëtari i Këshillit relator i çështjes ka proceduar me përgatitjen e

relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

29. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, zv/Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 17.07.2020, ora 13 e 30, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt urdhërimin e ndalimit të kandidimit të zotit Shaqir Hasanaj, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019.

30. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatit Shaqir Hasanaj.

31. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

32. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 17.07.2020, ora 13 e 30, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

33. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

34. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit Shaqir Hasanaj.

35. Avokati i Popullit parashtroi se ishte dakord në thelb me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidatit dhe ka sugjeruar disa elemente shtesë që duhet të përmbajë në të ardhmen relacioni në lidhje me përcaktimin e kohës së veprimeve (të përfundimit të hetimit prej relatorit apo të komunikimit të gjetjeve kandidatit). Po ashtu, sugjeroi që në drejtim të verifikimit të kriterit ndalues që lidhet me pasjen e pozicioneve drejtuese në parti politike të komunikohet në të ardhmen edhe me KQZ-në.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

36. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidimit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidatit Shaqir Hasanaj për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019.

37. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se:

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”

38. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;*
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.*

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;*
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;*
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”*

39. Kushtet e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji organik i Gjykatës Kushtetuese, duhet të plotësohen secili dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për t'u vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe, më tej, për t'u emëruar si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese nga organi respektiv i emërtesës.

40. Për rrjedhojë, nëse kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, kjo do të përbënte shkak ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të vënë në bisedim dhe për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

41. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, rezulton se ILDKPKI-ja, me shkresën nr. 113/25 prot., datë 07.11.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Shaqir Hasanaj dhe personat e lidhur me të.

42. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarinimin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Shaqir Hasanaj, ILDKPKI-ja në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.*
- b) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë.*
- c) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
- ç) *Nuk ka kryer deklarinim të rremë.*
- d) *Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

43. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara nga kandidati Shaqir Hasanaj në *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë* që ka depozituar pranë ILDKPKI-së, mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar analizën financiare dhe ka ardhur në përfundimet e tij, në raport me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e dërguara pranë Këshillit nga institucionet publike dhe private të treguara në pikën 15 të këtij Vendimi. Këshilli vlerësoi se, edhe pse Alpha Bank nuk i ka kthyer përgjigje Këshillit, rezulton se kjo bankë i ka kthyer përgjigje ILDKPKI-së dhe nuk rezulton që për këtë kandidat të ketë të dhëna financiare që ndikojnë në konkluzionet e ILDKPKI-së.

44. Mbi bazën e verifikimeve të kryera, Këshillit i rezulton se nuk ka gjetje që tregojnë të dhëna të padeklaruara apo mospërputhje të tyre me të dhënat e treguara në deklarinimet e bëra nga kandidati Shaqir Hasanaj pranë ILDKPKI-së me *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë*.

45. Gjithashtu, Këshilli e vlerësoi të plotë dhe ezaurues, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, hetimin e thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga ILDKPKI-ja, sikurse edhe përfundimet e këtij institucioni mbi kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Shaqir Hasanaj.

46. Për këto arsye, në zbatim të shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si dhe të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Shaqir Hasanaj ka *“kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij”*. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, **ky kandidat nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.**

47. Për sa i përket procedurës së verifikimit të integritetit, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016 dhe shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, referuar akteve të sjella nga Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar si dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme, në përmbajtje të të cilave njoftohen fakte në përputhje me ligjin për integritetin e figurës së z. Shaqir Hasanaj, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në zbatim të shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si dhe të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, vjen në përfundimin se kandidati Shaqir Hasanaj **nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të integritetit.**

48. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se kandidati Shaqir Hasanaj plotëson kushtin e arsimit të lartë juridik, pasi ka një Diplomë të Nivelit të Dytë, sikurse kërkohet nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000. Rezulton se kandidati Shaqir Hasanaj ka përfunduar studimet e larta në Universitetin

e Tiranës në Fakultetin e Drejtësisë në periudhën 1991-1995, duke u diplomuar si “*Jurist*”. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

49. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë *të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidati Shaqir Hasanaj ka ushtruar veprimtari profesionale si:

- a) Jurist i Përgjithshëm pranë Radio Televizionit Shqiptar në periudhën 01.03.1993 – 10.02.1996;
- b) Asistent pedagog në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, në lëndën “E drejta e detyrimeve”, për periudhën 1995 – 1997;
- c) Gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 08.02.1996 – 25.05.1999;
- d) Avokat në periudhën 2001 – 2012;
- e) Këshilltar juridik pranë Presidentit të Republikës në periudhën 26.07.2012 – 25.07.2017;
- f) Avokat për periudhën 2018 e në vijim.

50. Bazuar në gjetjet e cituara si më sipër, Këshilli konstaton se kandidati Shaqir Hasanaj **plotëson kërkesën ligjore për ushtrimin e së paku 15 vjet përvojë pune si gjyqtar dhe avokat.**

51. Duke vijuar me verifikimin e kushteve ligjore, evidentohet se pika 1 e nenit 237 të ligjit nr. 115/2016, të referon në ligjin për Gjykatën Kushtetuese nr. 8577/2000, i cili në nenin 7/a, pika 1, shkronja “c” parashikon si kusht që kandidati “*të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*”, ndërsa në shkronjën “d” të pikës 1, të po këtij neni, parashikon si kusht që kandidati “*të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi*”.

52. Për sa i përket kushtit të parashikuar nga shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që kandidati “*të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i është drejtuar institucioneve publike dhe subjekteve private, pranë të cilave kandidati Shaqir Hasanaj ka ushtruar funksione publike apo private. Me shkresën nr. 3795/1 prot., datë 05.11.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të Institucionit të Presidentit të Republikës ka ardhur përgjigja se:

“...Zoti Shaqir Hasani ka qenë punonjës i Institucionit të Presidentit të Republikës, ku ka ushtruar detyrën e Këshilltarit Juridik të Presidentit të Republikës, prej datës 26.07.2012 deri në datën 25.07.2017.

Siç rezulton nga aktet e emërimit, zoti Hasanaj është emëruar në detyrën e Këshilltarit Juridik bazuar në nenin 30, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil” dhe nenit 8 e 14 të ligjit nr. 8095, datë 21.03.1996 “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”.

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, si dhe organikave bashkëlidhur, zoti Hasanaj ka qenë pjesë e stafit politik pranë Institucionit të Presidentit të Republikës...”.

53. Në lidhje me funksionin e ushtruar prej tij si Këshilltar Juridik pranë Presidentit të Republikës për periudhën 26.07.2012 - 25.07.2017, kandidati, z. Shaqir Hasanaj, ka parashtruar se:

- *Funksioni i këshilltarit juridik pranë Presidentit të Republikës nuk mund të konsiderohet si funksion politik, sipas nenit 125 pika 5 të Kushtetutës dhe nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 të ndryshuar, pasi Presidenti i Republikës nuk ushtron funksione politike apo partiake, por ushtron detyrat kushtetuese dhe ligjore si kryetari i shtetit dhe se i ndalohet të kryejë funksione dhe veprimtari politike;*
- *Ligji nr. 152/2013 nuk e njeh terminologjinë e funksionarit politik dhe se sipas këtij ligji administrata e Presidentit të Republikës konsiderohet si pjesë e administratës së një institucioni të pavarur, duke shfuqizuar sakaq ligjin nr. 8300/1998 që ndryshoi ligjin nr. 8095/1996;*
- *Ligji nr. 90/2012 parashikon se status politik kanë vetëm administrata e kabinetit të ministrave apo të Këshillit të Ministrave;*
- *Nëse do të interpretohej ndryshe do të përjashtoheshin nga kandidimi në Gjykatën Kushtetuese një kategori i gjerë e profesionistëve, duke i pamundësuar ecurinë e karrierës përgjatë 10 viteve;*
- *Funksionarët e kabinetit të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Avokatit të Popullit, Prokurorit të Përgjithshëm, Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit etj. nuk mundet të konsiderohen si funksionarë politikë, pasi asnjë nga detyrat e tyre nuk ka karakter politik dhe se këto funksione nuk mund të barazohen me deputetët, ministrat, Kryeministrin, zëvendësministrat apo drejtorët dhe funksionarët e tyre të kabinetit, duke pasur parasysh edhe opinionin e ndërmjetëm të Komisionit të Venecias;*
- *Këshilli i Emërimeve në Drejtësi duhet të zbatojë drejtpërdrejtë Kushtetutën, pasi ajo i imponohet dhe prevalon mbi ligjin;*
- *Me Vendimin nr. 100, datë 30.07.2019 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka konkluduar se pozicioni i këshilltarit juridik pranë Presidentit të Republikës nuk është pozicion politik dhe se për rrjedhojë nuk mundet që të ndryshohet qasja dhe vendimmarrja e mbajtur nga një organ kushtetues.”.*

54. Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, sikurse është parashtruar më lart, si edhe nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidimit për veprimtaritë e ushtruara, Këshilli konstaton se kandidati Shaqir Hasanaj ka ushtruar funksione politike në administratën publike (gjatë 10 viteve të fundit të kandidimit). Në arritjen e këtij konkluzioni, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke vërejtur se shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 është një normë përcaktuese, vlerëson t’i referohet dispozitave ligjore përkufizuese, që përgjatë harkut kohor të ushtrimit të funksionit të cituar të kandidatit, kanë parashikuar se cilat janë funksionet politike në Republikën e Shqipërisë.

55. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi sjell edhe një herë në vëmendje se sipas shkresës nr. 3795/1 prot., datë 05.11.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm i Institucionit të Presidentit të Republikës Zoti Shaqir Hasani është emëruar në detyrën e Këshilltarit Juridik bazuar në nenin 30, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil” dhe nenit 8 e 14 të ligjit nr. 8095, datë 21.03.1996 “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, legjislacion parashikues që vepronte në këtë fushë deri në shfuqizimin e dispozitave të fundit të tij me ligjin nr. 152/2013

“Për nëpunësin civil” (në vijim ligji 152/2013) dhe me aktin normativ nr. 5, datë 30.09.2013 i miratuar me ligjin nr. 161/2013.

56. Sipas parashikimit të nenit 2 të ligjit nr. 152/2013, ky ligj nuk vepron për funksionarët e emëruar nga Presidenti i Republikës apo funksionarët e kabinetit. Ndërsa sipas përkufizimit të termave të nenit 4 të ligjit nr. 152/2013, shpjegohet në shkronjën “ç” se: *“Funksionar i kabinetit” është nëpunësi, pjesë e kabinetit të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, ministri përgjegjës për administratën publike, apo pjesë e kabinetit të një titullari të një institucioni të pavarur apo një funksionari të emëruar nga Kuvendi ose Presidenti, nëse parashikohet nga ligji, që kryen detyra të drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit apo sekretarit personal të titullarit të kabinetit*”. Pra, funksionari i kabinetit është i ndryshëm nga nëpunësi civil. Përkufizimi i nëpunësit civil jepet në shkronjën “c”, të së njëjtës dispozitë ligjore dhe është *“personi që kryen funksionin për ushtrimin e autoritetit administrativ, publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizimit, i cili merr pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre”*.

57. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi sjell në vëmendje se termat funksionarë politikë identifikohen nga ligjvënësi në vitin 2016, në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016) dhe ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 96/2016) pjesë e të njëjtës paketë, me ligjin nr. 115/2016, të Reformës në Drejtësi. Konkretisht, në pikën 17 të nenit 3 të këtij ligji, për të identifikuar sakaq se cilat funksione publike do të konsideroheshin si të papajtueshme me detyrën e komisionerit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe anëtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (shih nenin 6 shkronja “ç” të ligjit nr. 84/2016), Sekretarit të Përgjithshëm (shih shkronjën “dh” pika 3 të nenit 20), parashikohet se: *“17. Shprehja “nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike” do të thotë që nuk ka qenë deputet, Kryeministër, Zëvendëskryeministër, ministër, zëvendësministër ose nëpunës pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, 3 Zëvendëskryeministrit, ose ministrit që kryen detyrën e drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit ose sekretarit personal të titullarit të kabinetit.”*

58. Për më tej, në mënyrë eksplicite, njësoj si ligji nr. 8577/2000, i ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, parashikon edhe ligji nr. 96/2016, se nuk mund të këtë statusin e gjyqtarit personi që ka mbajtur funksione politike në administratën publike në 10 vitet e fundit nga kandidimi. Është pikërisht ky ligj (nr. 96/2016) që përkufizon edhe tipikisht termat në lidhje me statusin e gjyqtarit, në nenin 2 shkronja “ç” se: *“Nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike” do të thotë që nuk ka qenë deputet, Kryeministër, Zëvendëskryeministër, ministër, zëvendësministër ose nëpunës, pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit ose ministrit, që kryen detyrën e drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit ose sekretarit personal të titullarit të kabinetit”*.

59. Në dispozitat e sipërcituara, është përcaktuar kuptimi i termave të togfjalëshit “funksione politike në administratën publike”, si në drejtim të konceptit “administratë publike”, ashtu dhe të konceptit “funksion politik”. Kështu, “administratë publike” është konsideruar edhe kabineti i Presidentit të Republikës krahas kabinetit të Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, ministrit etj., ndërsa “funksioni politik” i referohet detyrës konkrete, ku përfshihen detyra e drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, sekretarit personal të titullarit të kabinetit. Këshilli konkludon se kuptimi i kushtit ndalues “funksione politike në administratën publike”, i përcaktuar nga neni 125, pika 5 të Kushtetutës dhe nga neni 7/a, shkronja “c” i ligjit nr. 8577/2000, është i njëjtë me

kuptimin e të njëjtit togfjalësh të përcaktuar në dispozitat e përkufizimeve në ligjin nr. 84/2016 dhe nr. 96/2016. Në arritjen e këtij konkluzioni, Këshilli mban në konsideratë edhe për sa parashtrohet në vijim.

60. Ky togfjalësh termash është përdorur si kusht ndalues jo vetëm për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, por edhe në një sërë dispozitash të tjera, që kanë të bëjnë me kandidatët për organet e tjera kushtetuese, përmendur edhe në paragrafët e mësipërm, e më konkretisht:

- a. Në nenin 136 të Kushtetutës për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë nga radhët e juristëve.
- b. Në nenin 147/3 të Kushtetutës për anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor që përzgjidhen nga radhët e juristëve.
- c. Në nenin 148/a/4 të Kushtetutës për kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm.
- d. Në nenin 149/3 të Kushtetutës për kandidatët joprokurorë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.
- e. Në nenin C pika 6 të Aneksit të Kushtetutës për kandidatët për anëtarë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe kandidatët për anëtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

61. Sipas këtyre dispozitave, rezulton se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka zgjedhur të përjashtojë nga kandidimi, personat që kanë mbajtur funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit, në të gjitha organet e sistemit të drejtësisë, organet e *vettingut* dhe Gjykatën Kushtetuese. Kjo është bërë me një qëllim të lartë kushtetues, për të shmangur çdo lloj perceptimi për ndikim të drejtpërdrejtë ose indirekt të politikës mbi sistemin e drejtësisë dhe për të rritur besueshmërinë në pavarësinë e paanshmërinë e sistemit gjyqësor. Duke qenë se i njëjti kusht ndalues është përdorur si për kandidatët e organeve të *vettingut*, për kandidatët për Gjykatën e Lartë e Prokuror të Përgjithshëm ose anëtarët e KLGJ-së dhe KLP-së jogjyqtarë, atëherë është e qartë se ky kusht ndalues ka të njëjtin kuptim në çdo rast të kandidimit në pozicionet e cituara në dispozitat e mësipërme të Kushtetutës. Vetëm në këtë situatë ky kusht ndalues do të përmbushte qëllimin për të cilin është parashikuar në Kushtetutë. Çdo interpretim i ndryshëm që mund t'i bëhet këtij kushti në varësi të pozicionit për të cilin konkurohet do të shkaktonte diferencim të zbatimit të tij, megjithëse kuptimi që i ishte dhënë nga ligji më i lartë themelor i shtetit është i njëjtë. Lidhur me organet kushtetuese, funksionimi i të cilave në mënyrë të detajuar rregullohet me ligje të veçanta, ndiqet parimi i interpretimit të njëjtë të koncepteve për të siguruar zbatimin unik të dispozitave kushtetuese.

62. Mungesa e përkufizimit të termave të togfjalëshit “funksione politike në administratën publike” në ligjin nr. 8577/2000, i ndryshuar me ligjin nr.99/2016, nuk do të thotë se ligjvënësi ka pasur si qëllim t'i japë një kuptim të ndryshëm termave të këtij togfjalëshi në këtë ligj, nga ligjet e tjera nr .84/2016 dhe nr. 96/2016, që siç është argumentuar edhe më sipër, janë pjesë e të njëjtës paketë të Reformës në Drejtësi. Ligjvënësi, në ligjin nr. 99/2016 nuk ka dhënë përkufizimin e asnjë togfjalëshi ose koncepti, të përfshirë në përmbajtjen e tij, gjë që është bërë qëllimisht, pasi përkufizimet e termave të përdorura në këtë ligj janë dhënë në mënyrë të detajuar në ligjet e tjera pjesë e paketës së reformës në drejtësi, të cilat janë miratuar pak kohë më parë se ky ligj. Duke qenë se në këto ligje është rregulluar mënyra e organizimit të institucioneve të tjera kushtetuese si dhe ai për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ato në mënyrë pararendëse kanë sqaruar kuptimin e termave të togfjalëshit “funksione politike në administratën publike”, gjë që e bënte të panevojshme ripërsëritjen e përkufizimit të termave të këtij togfjalëshi edhe në ligjin e mëvonshëm nr. 99/2016. Për këtë arsye, referimi te ligji nr. 84/2016 dhe ligji nr. 96/2016 duhet bërë në kuadër të interpretimit harmonik të dispozitave ligjore të paketës së Reformës në Drejtësi.

63. Këto parashikime ligjore nuk lënë hapësirë për interpretim të ndryshëm të termave të togfjalëshit “funksione publike në administratën publike” për kategorinë e nëpunësve që kanë qenë pjesë e stafit të kabinetit të Presidentit sipas përcaktimeve të përkufizimeve të ligjit nr. 84/2016 dhe nr. 96/2016. Ligjvënësi ka pasur si qëllim të shmangë përfshirjen në organet e sistemit të drejtësisë të të gjithë funksionarëve politikë, pavarësisht nga institucioni pranë të cilit ata kanë realizuar këtë funksion, qoftë ky edhe Institucioni i Presidentit. Në kushtet, kur kandidati ka mbajtur funksione politike në administratën publike deri në vitin 2017, ai për shkak të ligjit është i përjashtuar nga kandidimi për anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

64. Për sa më sipër, Këshilli, arrin në përfundimin se kandidati Shaqir Hasanaj ka qenë këshilltar juridik pranë Presidentit të Republikës në periudhën 26.07.2012 - 25.07.2017, ndaj ai **nuk plotëson kushtin për lejimin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.**

65. Në lidhje me kriterin e parashikuar në shkronjën “d” të pikës 1 të nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që kandidati “*të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi*”, rezulton e provuar nga shkresa nr. 5180/1 prot., datë 25.10.2019 e Këshillit të Lartë Gjyqësor se:

- Z. Shaqir Hasanaj me Vendimin nr. 28/1, datë 20.03.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë i është dhënë masa disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim*”.
- Z. Shaqir Hasanaj me Vendimin nr. 37, datë 25.05.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë i është dhënë masa disiplinore e “*Shkarkimit nga detyra e gjyqtarit*” për mosparaqitje në provimin e kualifikimit profesional.

66. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me shkresën nr. 715 prot., datë 08.11.2019 ka kërkuar informacion të mëtejshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me gjyqtarët e shkarkuar për mospjesëmarrje në provimin e organizuar sipas ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (*në vijim ligji nr. 8436/1998*), vendimet dhe dokumentacionin përkatës dhe se sa prej gjyqtarëve të shkarkuar janë rikthyer në detyrë, mënyrën se si janë rikthyer dhe dokumentacionin përkatës. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përcjellë me shkresën nr. 5591/1 prot., datë 13.11.2019 informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar. Nga këto të dhëna nuk rezulton që kandidati Shaqir Hasanaj të jetë rikthyer në detyrën e gjyqtarit dhe nuk rezulton që vendimi i shkarkimit nga detyra të ketë qenë objekt revokimi nga organi administrativ apo objekt shfuqizimi nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë (shih nenin 147 të Kushtetutës së pandryshuar në vitin 2016).

67. Edhe në lidhje me masat disiplinore në ngarkim Këshilli ka kërkuar mendimin e kandidatit Shaqir Hasanaj. Ky i fundit me shkresën nr. 51 prot., datë 17.02.2020, ka parashtruar se:

- *Masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” nuk mundet të jetë e përvetshme dhe se me kalimin e dy viteve kjo masë nuk duhet të ekzistonte më në dosje pasi është parashkruar;*
- *Vendimi nr. 37, datë 25.05.1999 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra për mosparaqitje në provim është nul dhe antikushtetues, pasi Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 59, datë 05.11.1999 ka shfuqizuar si antikushtetues paragrafin e tretë të nenit 48 të Ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998;*
- *Gjithashtu me vendimin nr. 3, datë 20.02.2006 të Gjykatës Kushtetuese është vendosur shfuqizimi i pikës 6 të nenit 42 të ligjit nr. 8436/1998, duke konkluduar se shkaqet e shkarkimit janë të parashikuara në mënyrë shteruese në nenin 147/6 të Kushtetutës dhe se ligji nuk mund të parashikojë të tjera;*

- *Mosparaqitja në provim ka ardhur si pasojë e pamundësisë fizike dhe shëndetësore për shkak të sëmundjes, fakti i cili provohet nëpërmjet raportit mjekësor, provë e cila nuk është pranuar të merret parasysh;*
- *Isha në pamundësi të mbrohesha nga personat që kanë ushtruar tortura, kanë dënuar mua dhe prindërit dhe kanë shkatërruar familjet më të mira në Shqipëri;*
- *Unë luftova në atë kohë për të ruajtur drejtësinë e pakapur nga pushteti që të mos të degjeneronte deri këtu sa sot të vjen turp të thuash jam gjyqtar;*
- *Kualifikimi im do t'i shërbente grupit të të përndjekurve politik, pasi kjo ngjarje do të shënonte rikthimin në këtë gjykatë pas 76 vjetësh të të parit individ nga ky grupim shoqëror;*
- *Nga largimi kolektiv i 65 gjyqtarëve një pjesë e tyre janë kthyer dhe vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e gjyqtarit dhe se nuk mund të mbahen dy standarde mbi këtë çështje;*
- *Këshilli i Emërimeve në Drejtësi duhet të vendosë lejimin e kandidimit tim.*

68. Lidhur me masën disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim*”, marrë me Vendimin nr. 28/1, datë 20.03.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, sikurse është parashtruar më lart, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke iu referuar ligjit nr. 96/2016 që është aktualisht në fuqi, konstaton se masa disiplinore “*vërejtje me paralajmërim*” nuk parashikohet nga legjislacioni si masë disiplinore, por tashmë parashikohen masat disiplinore “*vërejtje konfidenciale*” dhe “*vërejtje publike*”. Në rastin e parë ligji nuk parashikon shënimin në regjistër dhe në rastin e dytë ligji parashikon se masa disiplinore shuhet dhe fshihet nga regjistri pas kalimit të afatit dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të masës disiplinore. Për rrjedhojë, bazuar në parimin e ligjshmërisë, konkludohet që masa disiplinore “*vërejtje me paralajmërim*”, e marrë nga KLD-ja në datën 20.03.1999 ndaj kandidatit, z. Shaqir Hasanaj, është shuar.

69. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi sjell në vëmendje se ligji nr. 8436/1998, që ka qenë në fuqi në kohën e dhënies së masave disiplinore ndaj kandidatit, në nenin 42 parashikonte se ndaj shkeljeve disiplinore mund të merren masat disiplinore si më poshtë: vërejtje; vërejtje me paralajmërim; ulje në pagë deri në masën 25 për qind për një periudhë nga 3 - 6 muaj; pezullim nga detyra dhe kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda gjykatës për një periudhë nga gjashtë muaj deri në një vit; transferim në një gjykatë tjetër; shkarkim nga detyra. Në këtë ligj nuk parashikoheshin afate për parashkrimin dhe shuarjen e masave disiplinore.

70. Ligji nr. 9877, datë 18.02.2008 “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 8436/1998, në nenin 33 kategorizonte shkeljet disiplinore të gjyqtarëve në tre lloje, konkretisht shkelje të lehta, shkelje të rënda dhe shkelje shumë të rënda. Pika 3 e kësaj dispozite parashikonte se për shkeljet shumë të rënda disiplinore jepej masa e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit. Pika 6 e kësaj dispozite parashikonte edhe afatet e parashkrimit të masave disiplinore që jepeshin për shkeljet e rënda dhe të lehta të disiplinës nga ana e gjyqtarëve. Kjo pjesë e dispozitës parashikonte se për efekt të procedimit disiplinor, masat disiplinore të rënda shlyhen brenda 3 vjetëve nga data e dhënies së tyre, në qoftë se nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore, ndërsa masat disiplinore të lehta shlyhen brenda 2 vjetëve nga data e dhënies së tyre, në qoftë se nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sa më lart, konkludon se masa disiplinore për shkeljet shumë të rënda në detyrë të gjyqtarëve nuk parashkruheshin.

71. Në terma të tjera, për efekt të zbatimit të drejtë të shkronjës “d” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, nuk mundet të mjaftojë për vendimmarrjen e ndalimit të kandidimit vetëm ekzistenca e një mase disiplinore e ndryshme nga shkarkimi, por duhet që kjo masë disiplinore të jetë në fuqi, që do të thotë që të mos jetë shfuqizuar nga organi epror administrativ, të mos jetë

shfuqizuar apo të mos jetë konstatuar apo shpallur e pavlefshme nga gjykata apo edhe të mos jetë shuar sipas afateve ligjore. Në rastin konkret masa disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim*” e marrë në cilësinë e gjyqtarit për z. Shaqir Hasanaj është dhënë në vitin 1999. Duke qenë se nga momenti i dhënies së masës e deri në momentin e kandidimit kanë kaluar 20 vjet, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konkludon se masa disiplinore është shuar dhe, për rrjedhojë, nuk është në fuqi. Kjo do të thotë se kjo masë disiplinore nuk mund të shërbejë si pengesë për kandidimin e Z. Shaqir Hasanaj.

72. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konstaton se përkundrejt z. Shaqir Hasanaj, në cilësinë e gjyqtarit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë me Vendimin nr. 37, datë 25.05.1999, i cili është i formës së prerë dhe përfundimtar, ka marrë masën disiplinore të “*Shkarkimit nga detyra të gjyqtarit*”. Shkak për këtë vendimmarrje dhe masë disiplinore është bërë fakti se z. Shaqir Hasanaj nuk ka marrë pjesë në provimin e kualifikimit profesional, që është zhvilluar në atë kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 8436/1998.

73. Këshilli vëren se, sipas nenit 48 të ligjit nr. 8436/1998, i miratuar në bazë të nenit 147 të Kushtetutës, gjyqtari kur shkarkohet nga detyra për një nga arsytet e parashikuara në Kushtetutë, kishte të drejtë të ankohej në Gjykatën e Lartë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Më tej kjo normë parashikonte se gjykimi i çështjes bëhej nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Nga aktet e administruara nuk rezultojnë që kandidati ta këtë kundërshtuar masën disiplinore të “*Shkarkimit nga detyra*”, sipas ligjit, për rrjedhojë, në kushtet kur ajo nuk është shfuqizuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si organi kompetent për shqyrtimin e ligjshmërisë së këtyre vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli vlerëson kjo masë disiplinore është akoma në fuqi.

74. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ndryshe nga sa pretendon në parashitesën e tij kandidati Shaqir Hasanaj, vlerëson se vendimi i Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e paragrafit të tretë të nenit 45 të ligjit nr. 8436/1998, nuk mundet të përbëjë rrethanë ligjore që të passjellë shfuqizimin automatik dhe *ex lege* të masave disiplinore të marra nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për secilin gjyqtar, cilido qoftë shkak i marrjes së masës disiplinore, qoftë ky edhe për shkakun e moskalkimit të provimit apo për shkakun e mosparaqitjes në provimin profesional të zhvilluar. Meqenëse masa disiplinore është një masë individuale, po ashtu është edhe shfuqizimi i saj.

75. Gjithashtu, referuar si ligjit të kohës, ligjit pasues ashtu edhe ligjit të sotëm, i cili në mënyrë eksplicite parashikon se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk shuhet dhe nuk fshihet nga regjistri, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konkludon se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra e gjyqtarit, marrë me Vendimin nr. 37, datë 25.05.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përkundrejt z. Shaqir Hasanaj është në fuqi. Për rrjedhojë, në rastin konkret Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konkludon se z. Shaqir Hasanaj është larguar nga detyra e gjyqtarit për shkaqe disiplinore dhe ka masë disiplinore në fuqi, fakt i cili shkakton krijimin e një pengese ligjore për të vijuar kandidimin për anëtar në Gjykatën Kushtetuese.

76. Për sa më sipër, Këshilli, konstaton se kandidati Shaqir Hasanaj është larguar nga detyra e gjyqtarit për shkaqe disiplinore dhe ndaj tij ka masë disiplinore në fuqi, për rrjedhojë ai **nuk plotëson kushtin për lejimin e kandidimit të parashikuar nga shkronja “d” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.**

77. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacioni që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidatit z. Shaqir Hasanaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d dhe nenit 125 të Kushtetutës, të neneve 7/a dhe 7/c të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të pikës 3 të nenit 229, pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236 dhe pikës 3 të nenit 237 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “a” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatit Shaqir Hasanaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Shaqir Hasanaj.
3. Kandidati Shaqir Hasanaj ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Zv/KRYETARE

Vitore TUSHA



MENDIM PARALEL

Ne anëtarët Fiona Papajorgji dhe Fatjona Memçaj, pajtohem me vendimin nr. 15, datë 17.07.2020, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për ndalimin e kandidimit të kandidatit z. Shaqir Hasanaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, por ndajmë mendim të ndryshëm me arsyetimin e vendimit të lartpërmendur në pikat 54 deri 64, që i përkasin vlerësimit të Këshillit në lidhje me mbajtjen e funksioneve politike nga ana e tij për shkak të ushtrimit të detyrës si këshilltar juridik i Presidentit të Republikës, për arsyet si më poshtë.

Neni 125, pika 5 e Kushtetutës parashikon se gjyqtari kushtetues *“nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit”*. Në zbatim të normës kushtetuese neni 7/a, pika 1, shkronja “c” i ligjit nr. 8577/2000, si kusht të emërimit të gjyqtarit kushtetues parashikon që *“të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit”*.

Edhe pse Kushtetuta dhe ligji organik i Gjykatës Kushtetuese përcaktojnë si kusht ndalues për gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese faktin që kandidati *të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike*, për këtë detyrë (anëtar i Gjykatës Kushtetuese), ato nuk japin ndonjë përkufizim të termit *“funksion politik”*, si dhe nuk përcaktojnë rrethin e subjekteve që kryejnë funksione politike. Ndërkohë që ligjvënësi ka rregulluar dhe specifikuar në ligje të tjera të posaçme, për fushën e veprimit të këtyre ligjeve, konceptin në fjalë¹. Prandaj, jemi të mendimit se nëse ligjvënësi do kishte pasur qëllim që të konsideronte si pozicion politik edhe këshilltarin juridik të Presidentit për kandidatët për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, edhe në ligjin nr. 8577/2000, kur ka përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për gjyqtarë kushtetues, do të përdorte të njëjtën teknikë legjislativë që ka bërë në ligjet e tjera [shih

¹ Neni 3/17 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se: *“Shprehja “nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike” do të thotë që nuk ka qenë deputet, Kryeministër, Zëvendëskryeministër, ministër, zëvendësministër ose nëpunës pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, ose ministrit që kryen detyrën e drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit ose sekretarit personal të titullarit të kabinetit”*.

Neni 2/ç i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” citon se: *“Nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike” do të thotë që nuk ka qenë deputet, Kryeministër, Zëvendëskryeministër, ministër, zëvendësministër ose nëpunës, pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit ose ministrit, që kryen detyrën e drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit ose sekretarit personal të titullarit të kabinetit”*.

Neni 4/ç i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” parashikon se: *““Funksionar i kabinetit” është nëpunësi, pjesë e kabinetit të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, ministri përgjegjës për administratën publike, apo pjesë e kabinetit të një titullari të një institucioni të pavarur apo një funksionari të emëruar nga Kuvendi ose Presidenti, nëse parashikohet nga ligji, që kryen detyra të drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit apo sekretarit personal të titullarit të kabinetit”*.

Neni 17/1 i ligjit 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” citon se: *“Kabineti i ministrit mund të ketë një drejtor, këshilltarët dhe sekretarët. Ata emërohen dhe shkarkohen nga ministri dhe kanë statusin e funksionarëve politikë, sipas ligjit”*.

ligjin për statusin e gjyqtarëve nr. 96/2016, në të cilin shprehimisht është ndaluar kandidimi i këshilltarit të Presidentit si për emërimin magjistrat të ish-gjyqtarëve dhe ish-prokurorëve (neni 36), ashtu edhe për emërimin e kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë (neni 49), apo edhe ligjin e rivlerësimit kalimtar nr. 84/2016, ku edhe këtu shprehimisht është ndaluar kandidimi i këshilltarit të Presidentit për institucionet e rivlerësimit].

Gjithashtu vërejmë se, Këshilli, në veprimtarinë e tij të verifikimit të kushteve ligjore dhe vlerësimit të kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, ka vlerësuar dhe më parë (shih vendimin nr. 100, datë 30.07.2020) pozicionin e këshilltarit juridik të Presidentit të Republikës, duke arritur në përfundimin se kjo detyrë nuk mund të konsiderohet funksion politik në administratën publike, në kuptim të ligjit nr. 155/2016 (edhe në këtë ligj nuk jepet kuptimi i shprehjes “funksion politik”). Në mendimin tonë, të njëjtat vlerësime të bëra nga Këshilli më parë, vlejné edhe në rastin në shqyrtim.

Gjithsesi, për të përcaktuar nëse pozicioni i këshilltarit juridik të Presidentit duhet apo jo konsideruar “funksion politik”, duhet t’i referohemi detyrave të ushtruara në konkret prej tij në institucionin e Presidentit të Republikës, në funksion të rolit dhe kompetencave të Presidentit të përcaktuara nga Kushtetuta dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

Sipas nenit 86/1 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës është Kryetar i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit. Nisur nga ky formulim kushtetues, në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, theksohet se hartuesit e Kushtetutës e konceptuan rolin e tij si atë të arbitrit, të moderatorit të pushteteve e të rregullatorit, si një figurë neutrale, me një funksion të rëndësishëm në zgjidhjen e krizave, në balancimin e pushteteve, si dhe në kryerjen e detyrave të tyre respektive. Po ashtu, nga përmbajtja dhe fryma e Kushtetutës del se veprimtaria e Presidentit të Republikës si Kryetar shteti, ka elemente të tre pushteteve: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor (shih vendimin nr. 25, datë 13.02.2002 të Gjykatës Kushtetuese).

Në këtë këndvështrim, Gjykata Kushtetuese, për sa i përket pozicionit kushtetues të Presidentit, ka theksuar se kompetencat e tij janë përcaktuar në zbatim të parimit të shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, i cili nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Pra, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta, brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore. Për sa i përket kompetencave të Presidentit, ato janë të përcaktuara nga nenet 89, 90/1 dhe 94 të Kushtetutës, sipas të cilave ai nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private; nuk ka përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij dhe nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të (shih vendimin nr. 10, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese, prg. 9-10).

Nisur nga sa më lart, sikurse edhe Këshilli ka theksuar më parë, vlerësojmë se institucioni i Presidentit të Republikës nuk ushtron funksione të karakterit politik/partiak.

Nga ana tjetër, për sa i përket detyrave që ushtrojnë anëtarët e kabinetit të Presidentit, vlen të theksohet se kabineti është strukturë organizative ndihmëse që funksionon pranë Presidentit të Republikës dhe shërben si organ këshillimor pranë tij, duke e mbështetur drejtpërdrejtë atë në realizimin e kompetencave të tij. Për pasojë, edhe detyrat që kryen këshilltari juridik i Presidentit, gjatë ushtrimit të funksionit të tij, janë të lidhura ngushtë dhe bazohen në funksionet që Kushtetuta i përcakton Presidentit të Republikës dhe pozicionit të tij si përfaqësues i unitetit kombëtar, përfaqësues i shtetit, që qëndron mbi palët dhe që i ndalohet me Kushtetutë ushtrimi i çdo lloj veprimtarie politike.

Duke mbajtur në konsideratë këtë funksion të kabinetit të Presidentit, si dhe bazuar në rolin dhe kompetencat kushtetuese të Presidentit në një republikë parlamentare, mendojmë se punësimi pranë këtij institucioni, pra edhe detyra e këshilltarit juridik, nuk mund të konsiderohet i natyrës politike/partiake.

Si përfundim, vlerësojmë se kandidati z. Shaqir Hasanaj nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "c" e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

ANËTARE

Fiona PAPAJOJGJI



ANËTARE

Fatjona MEMÇAJ



MENDIM PAKICE

Në ndryshim me qëndrimin e mbajtur nga shumica e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në vendimin nr. 15, datë 17.07.2020 për ndalimin e kandidimit të kandidatit Shaqir Hasanaj, për vendin vakant të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, vakancë e parakohshme e rishpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 21.08.2019, në vijim paraqesim argumentet tona për qëndrimin në pakicë.

Në lidhje me kriterin e parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "c", e pikës 1, të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që kandidati "*të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*", Këshilli ka vlerësuar se kandidati Shaqir Hasanaj nuk plotëson kushtin për lejimin e kandidimit. Shumica ka arritur në këtë përfundim duke analizuar jo vetëm përmbajtjen e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, por edhe dispozitat ligjore që përgjatë harkut kohor të ushtrimit të funksionit të cituar të kandidatit, kanë parashikuar se cilat janë funksionet politike në Republikën e Shqipërisë.

Në ndryshim me qëndrimin e mbajtur nga shumica, vlerësojmë se funksioni i kandidatit Shaqir Hasanaj si këshilltar i Presidentit nuk mund të konsiderohet si funksion politik, për rrjedhojë nuk mund të përbëjë kusht ndalues për kandidimin e tij.

Neni 125, pika 5 e Kushtetutës parashikon se gjyqtari kushtetues "*nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit*". Në zbatim të normës kushtetuese neni 7/a, pika 1, shkronja "c" i ligjit nr. 8577/2000, si kusht të emërimit të gjyqtarit kushtetues parashikon që "*të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*".

Normat kushtetuese, si edhe ato të ligjit nr. 8577/2000 nuk kanë dhënë një përkufizim të termimit "funksion politik" dhe as nuk rezulton të kenë përcaktuar rrethin e subjekteve që kryejnë funksione politike. Në vlerësimin tim, kushtetutëbërësi dhe ligjvënësi nuk kanë ometuar në këtë drejtim, pasi në raste të tjera e kanë parashikuar në mënyrë të shprehur, duke dhënë konceptin dhe përkufizimin e këtij termi për qëllime të ligjit përkatës¹. Për rrjedhojë, në vlerësimin tonë, Këshilli nuk mund të bëjë referim në kushtet pengues që parashikojnë ligje të tjera, por vetëm në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligjin e posaçëm.

¹ Në ligjin nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve", neni 3, pika 17, parashikohet: "*Shprehja "nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike" do të thotë që nuk ka qenë deputet, Kryeministër, Zëvendës-krye-ministër, ministër, zëvendësministër ose nëpunës pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendës-kryeministrit, ose ministrit që kryen detyrën e drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit ose sekretarit personal të titullarit të kabinetit*". Në ligjin nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", neni 4, shkronja "ç", parashikohet se: "*Funksionar i kabinetit" është nëpunësi, pjesë e kabinetit të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, ministrit, apo pjesë e kabinetit të një titullari të një institucioni të pavarur apo një funksionari të emëruar nga Kuvendi ose Presidenti, nëse parashikohet nga ligji, që kryen detyra të drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit apo sekretarit personal të titullarit të kabinetit*". Në ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, neni 17, parashikohet se: "*1. Kabineti i ministrit mund të ketë një drejtor, këshilltarët dhe sekretarët. Ata emërohen dhe shkarkohen nga ministri dhe kanë statusin e funksionarëve politikë, sipas ligjit. 2. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e kabineteve miratohen nga Këshilli i Ministrave. Struktura dhe organika e kabinetit miratohen si pjesë e organizimit të brendshëm të ministrisë*".

Edhe në rastin konkret, i qëndrojmë arsyetimit të mbajtur në vendimin nr. 100, datë 30.07.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ku është konkluduar se funksionari i këshilltarit juridik pranë Presidentit, nuk mund të konsiderohet funksion politik në administratë publike, në kuptim të ligjit nr. 8577/2000. Në këtë vendim, në funksion të analizës mbi pozicionin “*këshilltar juridik i Presidentit*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në referim të Kushtetutës dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese lidhur me rolin dhe funksionet e Presidentit të Republikës, konkludoi se kompetencat kushtetuese dhe roli i Presidentit në Republikën Parlamentare, janë të tilla që punësimi pranë këtij institucioni nuk mund të konsiderohet i natyrës politike/partiake. Përderisa nga ana e institucionit të Presidentit të Republikës nuk ushtrohen funksione të karakterit politik/partiak, atëherë edhe anëtarët e kabinetit të Presidentit nuk mund të konsiderohen funksionarë politikë. Struktura e kabinetit mbështet drejtpërdrejtë Presidentin e Republikës në realizimin e kompetencave të tij dhe kabineti është strukturë organizative ndihmëse që funksionon pranë Presidentit dhe shërben si organ këshillimor pranë tij. Për pasojë, edhe funksioni i këshilltarit mbështetet në funksionet që Kushtetuta i përcakton Presidentit të Republikës dhe pozicionit të tij si përfaqësues i unitetit kombëtar, përfaqësues i shtetit, me funksion që qëndron mbi palët dhe që i ndalohet me Kushtetutë çdo veprimtari politike apo të pozicionuar politikisht (pika 74 e vendimit).

Për sa më sipër, vlerësojmë se për këtë kriter duhej të lejohej kandidimi i z. Shaqir Hasanaj.

Po ashtu, në lidhje me kriterin e parashikuar në shkronjën “d” të pikës 1 të nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që kandidati “*të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi*”, Këshilli ka konstatuar se kandidati Shaqir Hasanaj është larguar nga detyra e gjyqtarit për shkaqe disiplinore dhe ndaj tij ka masë disiplinore në fuqi, për rrjedhojë, ai nuk plotëson kushtin për lejimin e kandidimit të parashikuar nga shkronja “d” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

Nga aktet e administruara nga Këshilli, rezulton se me Vendimin nr. 37, datë 25.05.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për kandidatin është dhënë masa disiplinore e “*Shkarkimit nga detyra e gjyqtarit*” për mosparaqitje në provimin e kualifikimit profesional. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. 5591/1 prot., datë 13.11.2019, i ka kthyer përgjigje Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në lidhje me informacionin e kërkuar për gjyqtarët e shkarkuar për mospjesëmarrje në provimin e organizuar sipas ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (*në vijim ligji nr. 8436/1998*), vendimet dhe dokumentacionin përkatës dhe se sa prej gjyqtarëve të shkarkuar janë rikthyer në detyrë, mënyrën se si janë rikthyer dhe dokumentacionin përkatës. informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar. Sipas këtij informacioni dhe dokumentacionit të kërkuar nuk rezulton që kandidati Shaqir Hasanaj të jetë rikthyer në detyrën e gjyqtarit dhe nuk rezulton që vendimi i shkarkimit nga detyra të ketë qenë objekt revokimi nga organi administrativ apo objekt shfuqizimi nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Sipas shumicës, nuk rezulton që kandidati ta këtë kundërshtuar masën disiplinore të “*Shkarkimit nga detyra*”, sipas ligjit, për rrjedhojë, në kushtet kur ajo nuk është shfuqizuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si organi kompetent për shqyrtimin e ligjshmërisë së këtyre vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ajo është akoma në fuqi. Sipas shumicës, ndryshe nga sa pretendon kandidati Shaqir Hasanaj, vendimi i Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e paragrafit të tretë të nenit 45 të ligjit nr. 8436/1998, nuk mundet të përbëjë rrethanë ligjore që të passjellë shfuqizimin automatik dhe *ex lege* të

masave disiplinore të marra nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për secilin gjyqtar, cilido qoftë shkaku i marrjes së masës disiplinore, qoftë ky edhe për shkakun e moskalimit të provimit apo për shkakun e mosparaqitjes në provimin profesional të zhvilluar. Meqenëse masa disiplinore është një masë individuale, po ashtu është edhe shfuqizimi i saj. Po ashtu, sipas shumicës, referuar si ligjit të kohës, ligjit pasues ashtu edhe ligjit të sotëm, i cili në mënyrë eksplicite parashikon se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk shuhet dhe nuk fshihet nga regjistri, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra e gjyqtarit, marrë me Vendimin nr. 37, datë 25.05.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përkundrejt z. Shaqir Hasanaj është në fuqi, çka shkakton krijimin e një pengese ligjore për të vijuar kandidimin e tij për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

Në vlerësimin tonë, edhe pse është fakt që masa disiplinore për kandidatin Shaqir Hasanaj nuk është kundërshtuar prej tij dhe nuk rezulton të jetë shfuqizuar nga Gjykata e Lartë si organi kompetent, Këshilli duhej t'i kishte dhënë rëndësinë e duhur jo vetëm kohës së gjatë të kaluar nga dhënia e kësaj mase dhe shkaqeve për të cilat është dhënë ajo, por çka është më e rëndësishme, faktit që me vendimin Gjykatës Kushtetuese nr. 59, datë 05.11.1999 është shfuqizuar paragrafi i tretë i nenit 48 të ligjit nr. 8436/1998, i cili parashikonte shkarkimin e gjyqtarëve që nuk kalonin me sukses provimin e kualifikimit profesional.

Rezulton se vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) për masën e dhënë për kandidatin Shaqir Hasanaj është marrë përpara vendimit të Gjykatës Kushtetuese, për rrjedhojë, pas shfuqizimit të normës nga Gjykata Kushtetuese, në përputhje me parimin e fuqisë detyruese të vendimeve të kësaj Gjykate dhe efektit të tyre, KLD-ja duhej të kishte vlerësuar individualisht masat e dhëna, për sa kohë që baza ligjore për marrjen e këtyre vendimeve nuk ishte më në fuqi.

Për më tepër, në vendimin e saj nr. 3, datë 20.02.2006, Gjykata Kushtetuese, gjatë kontrollit të pajtueshmërisë me Kushtetutën të pikës 6, të nenit 42, të ligjit nr. 8436/1998, është shprehur se, shkarkimi nga detyra i gjyqtarit, e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi si dhe organi që duhet ta marrë atë në shqyrtim rregullohen drejtpërdrejt nga Kushtetuta. Kjo përbën një garanci më shumë për gjyqtarët për shkak të funksionit që ata kryejnë dhe misionin që u ka ngarkuar shteti dhe shoqëria.

Bazuar në sa më sipër, për sa kohë që shkaku i shkarkimit për kandidatin Shaqir Hasanaj nuk parashikohet shprehimisht në Kushtetutë, si dhe për shkak të rrethanave të veçanta të kësaj çështje, pra në situatën që norma ligjore bazë për dhënie e masës së shkarkimit ishte shfuqizuar si e papajtueshme me Kushtetutën, vlerësojmë se edhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi duhej të bënte një interpretim më të zgjeruar dhe në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore për rastin e kandidatit Shaqir Hasanaj.

Për sa më sipër, vlerësojmë se edhe për këtë kriter duhej të lejohej kandidimi i z. Shaqir Hasanaj.

ANËTAR
ARJAN QAFA

ZËVENDËSKRYETARE
VITORE TUSHA